E enjte, 20 prill 2023
[Seancë e hapur]
[Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]
[I akuzuari Krasniqi merr pjesë përmes videolidhjes]
--- Seanca fillon në orën 09.00

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi.

Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do fillojmë me Dëshmitaren 04421 të thirrur nga Prokuroria.

Për procesverbal, e di që z. Krasniqi po na ndjek sot përmes videolidhjes.

Përpara se të fillojmë, unë kam një urdhër me gojë sa i takon komenteve lidhur me pyetjet që bënë Gjykatësit dje në fund të seancës.

Z. KEHOE: [Përkthim] Përpara se të nxirrni urdhrin me gojë, do të kërkonim leje që të përfundonim parashtrimin tonë pastaj të kërkonim argumentet me gojë të Gjykatës përpara se të merret ndonjë vendim. Kjo është një çështje që i prefshin të gjithë dëshmitarët po sidomos dëshmitarët *viva voce*.

Besoj që kemi goxha dëshmitarë *viva voce* që do fillojnë

seancën e radhës. Dhe kjo është një çështje shumë e rëndësishme për të gjitha ekipet e Mbrojtjes dhe do të donim të kishim një mundësi të dorëzonim një kërkesë të përbashkët për Trupi Gjykues dhe pastaj që nxirrnit urdhrin me gojë lidhur me këtë parashtrim.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

Z. KEHOE: [Përkthim] Kam dhe një gjë tjetër. Shkurtimisht.

Dua të prezantoj një nga kolegët e mi, që është hera e parë që vjen, Jordan Behlman. Edhe meqë na keni thënë që duhet të njoftojmë kur vijnë persona të rinj, duhet t'i prezantojmë para Trupit Gjykues.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Ne do të vazhdojmë me urdhrin me gojë. Nuk do të presim për parashtrimin tuaj. I kuptojmë shumë mirë rrethanat. I kuptuam dje dhe ne jemi gati që për këtë të nxjerrim një urdhër me gojë.

Trupi Gjykues dëgjoi parashtrimet e Thaçit dhe të Selimit dje sa i takon sa i takon pyetjeve që bën Trupi Gjykues për dëshmitarin bazuar në deklaratat e mëparshme apo materialet që nuk janë pranuar si prova, gjatë pyetjeve dhe kundërpyetjeve të dëshmitarit.

Mbrojtja argumenton se Prokuroria duhet t'i drejtojë

dëshmitë e dëshmitarëve *viva voce* nëse gjykon që është e nevojshme dhe ne do të fokusohemi vetëm tek provat që nxjerr Prokuroria. Nëse Trupi Gjykues dëshiron të bëjë pyetje për materialet që Prokuroria përfshin në listën e prezantimeve, atëherë Mbrojtja duhet të bëjë kundrapyetjet për të gjitha prezantimet që ndodhen në listën nga ana e Prokurorisë. Dhe sigurisht që mund të fillojmë me kundrapyetjet dhe sigurisht që kjo kërkon shumë zgjatjen e afatit apo kohës për pyetjet. Nuk është e përshtatshme për Gjykatësit që të shohin për deklarata të papranuara të dëshmitarëve "për të nxjerrë pista të reja hetimi".

Gjykata e Apelit të Kosovës ka konstatuar që një dokument që është diskutuar me dëshmitarin nga Trupi Gjykues nuk ishte autentik. Dhe Mbrojtja duhet të ketë të drejtën të rifillojë pyetjet e veta bazuar në pyetjet që i janë drejtuar dëshmitarit.

Deklaratat e mëparshme të dëshmitarit që shërbejnë dhe që janë dhe baza e pyetjeve nga Gjykatësit ishin në listën e prezantimeve për këtë dëshmitar. Po ashtu ZPS-ja nxori dhe përmendi paragrafin 112 të Urdhrit për Zhvillimin e Procesit Gjyqësor ku kërkohet leje palëve dhe pjesëmarrësve të bëjnë pyetje dëshmitarit pasi Trupi Gjykues ka përfunduar me pyetjet e veta dhe vendos që Trupi Gjykues mund të bëjë të gjitha pyetjet që gjykon se janë të nevojshme.

Trupi Gjykues rikujton se Dhomat e Specializuara veprojnë

në sistemin e drejtësisë së Kosovës. Trupi Gjykues duhet të gjykojë dhe të funksionojë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjin për Dhomat e Specializuara dhe burimeve të tjera që janë përcaktuar në nenin 3 të këtij ligji. Trupi Gjykues nuk ka juri. Ata janë të mbështetur në fakt dhe në ligj. Dhe janë Gjykatës profesionistë që në mënyrë që të dalin me konstatimet e duhura mund të ndërmarrin të gjitha hapat që gjykojnë të nevojshëm për të zbuluar të vërtetën.

Për të bërë këtë, Trupi Gjykues, në bazë të nenit 40(6)(e) të Ligjit urdhëron nxjerrjen e dëshmive krahas atyre që janë mbledhur paraprakisht apo janë prezantuar para Trupit Gjykues nga palët.

Kjo është në përputhje me nenin 329(4) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës ku përcaktohet se "krahas provave të propozuara nga palët dhe palët e dëmtuara, Trupi Gjykues ka autoritetin të mbledhë provat që gjykon të nevojshme të domosdoshme për gjykimin e drejtë dhe të plotë të kësaj çështjeje". Sa i takon komentarit të kësaj dispozite ku thuhet se:

"Procedurat ballafaquese dhe barazia nuk do të thotë që Gjykatësi duhet të jetë thjesht një person pasiv, po mund të kërkojë informacione shtesë pasi Prokuroria dhe Mbrojtja ka në paraqitur provat e tyre.

Gjykata e Apelit ka bërë me dije në gjykimin e 19

dhjetorit 2016 se:

"Detyrimi i Gjykatës sipas nenit 7(1) të Kodit të Procedurës Penale është që të përcaktojë dhe të vërtetojë në mënyrë të plotë dhe të drejtë të gjitha faktet që janë të rëndësishme për të dalë me vendim të drejtë sipas nenit 329(4) ... sigurisht që Gjykata duhet të zbulojë të vërtetën. Dhe nuk cenon rregullat për mbledhjen e provave në këtë çështje konkrete. Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale janë tejet të qarta – gjatë gjykimit, mund të përdoren dhe intervista para fillimit të gjykimit si një instrument për kundrapyetjet".

Rregulla 132, 137(1) e Dhomave të Specializuara të Kosovës Rregullorja e Procedurës dhe e Provave pranon se "Trupi Gjykues mund të urdhërojë parashtrimin apo paraqitjen e provave që gjykon se janë të nevojshme për të zbuluar të vërtetën". Sipas rregullës 132 të Trupi Gjykues dhe pasi dëgjon palët, aty ku është e zbatueshme, "kërkon që të bëhen parashtrime ose *proprio motu* kërkon prova shtesë që nuk janë prodhuar nga palët, përfshirë prova nga ekspertët, kur e gjykon të nevojshme për zbulimin e të vërtetës".

Trupi Gjykues i bëri pyetje dëshmitarit dje lidhur me pjesë të transkriptove të intervistave që dëshmitari i ka dhënë ZPS-së dhe që ZPS-ja i kishte përfshirë në prezantimet e veta në *Legal Workflow* dhe që janë përdorur disa herë nga ekipet e mbrojtjes kur bënë kundrapyetjet e veta. Për më tej,

Trupi Gjykues i paraqet apo i bën pyetje dëshmitarit lidhur me një dokument që ishte i përfshirë në listën e prezantimeve të ZPS-së. Po ashtu Mbrojtja bëri të qartë njoftimin e vet sa i takon relevancës së këtyre dokumenteve apo provave të dëshmitarëve në fjalë dhe e dinin se këto dokumente mund të diskutoheshin nga dëshmitari. As një cenim nuk u shkaktua lidhur me këto pyetje.

Trupi Gjykues nuk kufizohet kur i bën pyetje dëshmitarëve vetëm në materialet që janë renditur në listën e prezantimeve të palës që e ka thirrur dëshmitarin. Fushëveprimi i pyetjeve gjyqësore është i gjerë dhe nuk kufizohet vetëm në një fushë të caktuar. Sipas rregullës 127(3): "Gjykatësi në çdo fazë mund t'i drejtojë pyetje dëshmitarit". Kjo dispozitë reflekton dispozitat dhe praktikat që janë në fuqi në juridiksionet që kanë miratuar një regjim të ngjashëm sa i takon provave. E njëjta gjë është bërë, ka qenë e pasqyruar në rregullën 85(b) të Rregullores së Procedurave dhe të Provave të TPNJ-së. Dhe më konkretisht është shqiptuar nga Dhoma e Apelit të TPNJ-së në gjykimi Popovic, që "kjo është një procedurë që është ndjekur edhe para Tribunalit në sisteme ballafaquese" dhe "Trupi Gjykues rrjedhimisht ka të drejtë t'i bëjë të gjitha pyetjet e nevojshme dëshmitarëve për të zbatuar siç duhet detyrën e vetë".

Në Tribunalin Penal Ndërkombëtar, Gjykatësit e Trupit Gjykues po ashtu konstatuan në vendimin e 18 marsit 2010 se

"nuk ka asnjë themel në kuadrin e Statutit të Romës apo në asnjë jurisprudencë tjetër përkatëse të gjykatave, ku të thuhet se Trupi Gjykues nuk duhet t'ju bëjë pyetje dëshmitarëve lidhur me faktet dhe aspektet që nuk janë trajtuar siç duhet nga mbrojtësit në sallën e gjyqit". "Sipas rregullës 140 të Rregullores së Procedurave dhe të Provave të Tribunalit Ndërkombëtar të Penales, ne kemi vepruar në të njëjtën mënyrë dhe ne kemi mundësinë dhe kemi të drejtën të eksplorojmë çdo aspekt të ri për sa kohë kjo është e nevojshme".

Trupi Gjykues vëren se Mbrojtja ka të drejtën të përsërisë pyetjet e veta bazuar në pyetjet që i janë drejtuar dëshmitarit nga Trupi Gjykues, pra, t'i bëjë kundrapyetjet përkatëse - më falni. Paragrafi 112 i Urdhrit mbi Zhvillimin e Procedura parashikon:

"Sa herë që i drejtohen pyetje dëshmitarit nga Trupi Gjykues pasi bëhen kundrapyetjet dhe pyetjet e drejtpërdrejta kanë të drejtë që me gojë të kërkojnë leje që t'i bëjnë edhe pyetje të tjera shtesë lidhur me pikat që janë diskutuar".

Kjo dispozitë është miratuar nga të gjitha palët dhe pjesëmarrësit. Trupi Gjykues nuk mori asnjë kërkesë për modifikimin apo ndryshimin e këtij paragrafi. Trupi Gjykues përfshin, sigurisht, që Trupi Gjykues është i kujdesshëm të mos cenohet asnjë nga palët për shkak të pyetjeve që ngre në Gjykatësit. Po ashtu zbatoi paragrafin 112 për të lejuar

kërkesën e Mbrojtjes në vijim të pyetjeve që ju bënë dëshmitarit. Prandaj Mbrojtja e ka shfrytëzuar këtë mundësi sa herë që e kanë gjykuar që është e nevojshme për ta që t'i bëjnë pyetje dëshmitarit pas pyetjeve që i janë drejtuar nga Trupi Gjykues.

Trupi Gjykues kërkon, në përputhje me rregullën 137(2) të vlerësohen lirisht të gjitha provat që janë dorëzuar paraprakisht për të përcaktuar pranueshmërinë dhe rëndësinë e tyre në përfundim të gjykimit. Palët kujtohen të mos supozojnë se Trupi Gjykues ka bërë ndonjë paragjykim apo ka cenuar vendime të ardhshme në lidhje me këto.

Sa i takon autenticitetit, Trupi Gjykues duhet sipas rregullës 138 të sigurojë që çdo provë e pranuar të jetë autentike. Paragrafi 47 i Urdhrit mbi Zhvillimin e Procesit Gjyqësor parashikon që:

"Palët mund ta kundërshtojnë një provë materiale dhe ta bëjnë këtë kundërshtim të qartë në momentin kur kjo provë kërkohet që të pranohet si provë".

Trupi Gjykues do të vlerësojë dhe të vendosë lidhur me çdo kundërshtim të paraqitur nga Mbrojtja për çdo dokument që dorëzohet në bazë të autenticitetit dhe këtë do ta bëjë në kohën e duhur.

Është detyra e Trupit Gjykues të sigurohet që gjykimi të jetë drejtë dhe i shpejtë. Trupi Gjykues ka garantuar dhe do të vijojë ta bëj që të mos ketë asnjë cenim të padrejtë për

palët që buron nga mënyra si u bëhen pyetjet dëshmitarëve dhe asnjë palë, pjesëmarrës apo vetë Trupi Gjykues.

Me këtë mbyll urdhrin me gojë.

Mund të sillnin dëshmitaren, Asistente e Gjykatës.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Përpara se të vijë dëshmitarja unë kam dy aspekte për të diskutuar.

Pikë së pari, dua të bëj prezantimin. Është hera e parë që dal para këtij Trupi Gjykues, jam Silvia D'Ascoli dhe përfaqësoj këtu Prokurorinë e Specializuar, është dhe Viki Andrys, juriste.

Dhe gjithashtu dua të merret një vendim lidhur me kërkesën që përcollëm me postë elektronike dje. Dëshmitari kërkon që të ketë një dosje me të gjitha kopjet [REDAKTUAR] [REDAKTUAR]. Ne mund t'ia japim Asistentes së Gjykatës edhe, sigurisht edhe kolegët përballë nesh mund ta shqyrtojmë, po do të përdoret vetëm nëse e kërkon dëshmitarja.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë kundërshtim?

Z. EMMERSON: [Përkthim] Do të donim ta shihnim dosjen përpara se ta shohë dëshmitarja.

Z. MISETIC: [Përkthim] Për sa kohë ndjekim të njëjtën procedurë si me dëshmitaren e parë që nuk mund t'i shohë kur dëshiron.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kërkesa është bërë me email nga dëshmitari edhe është dërguar dje para orës 9.00 të mëngjesit

më datën konkretisht më datën 19 prill.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca sot do të jetë e mbyllur dhe për këtë është nxjerrë urdhër më herët. Kështu që nga ky moment e në vijim seanca do të jetë e mbyllur.

Asistente, mund të sillni dëshmitaren.

[Seancë e mbyllur]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë pushimin e kafes dhe do të mblidhemi përsëri në orën 11.30.

--- Pauza fillon në orën 11.00

--- Seanca rifillon në orën 11.30

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në seancë të mbyllur, ju lutem. Dhe ndërkohë Asistentja mund të

sjellë Dëshmitaren në sallën e gjyqit.

[Seancë e mbyllur]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe.

Z. KEHOE: [Përkthim] Një kërkesë para se të bëjmë pushimin e drekës.

Më përpara na këshilluan që dëshmitari 02161 ishte zhvendosur për [REDAKTUAR], a mund të na e verifikojë prokuroria gjatë pushimit, a është e vërtetë që është shtyrë ky dëshmitar për [REDAKTUAR]? Sepse mesa duket dëshmitari 02161 ka [REDAKTUAR]. Dhe duam thjesht të kuptojmë a do të vazhdojmë në këtë formë.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, do ta shikojmë gjatë pushimit të drekës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni i çaktivizuar]

--- Pauza e drekës fillon në orën 13.06

--- Seanca rifillon në orën 14.30

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic. Keni përfunduar apo? Ndjesë.

Edhe një herë, ju lutem të shoqërojmë dëshmitaren brenda sallës së gjyqit dhe do të kalojmë në seancë të mbyllur përsëri.

Z. KEHOE: [Përkthim] Thjesht për të pyetur kolegët në qoftë se kemi ndonjë informacion të hollësishëm për 0216

[sipas përkthimit].

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Do të pres derisa të kalojmë në seancë të mbyllur dhe pastaj do t'i përgjigjem këtij shqetësimi.

[Seancë e mbyllur]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, mbyllim seancën sot dhe takohemi më 10 maj në orën 09.00. Faleminderit për kohën dhe pjesëmarrjen tuaj.

Shihemi për disa javë.

--- Seanca mbyllet në orën 15.13